Nga shkolla ... në shtëpi!

Ushtrime-lojra për prindër e fëmijë

Mos vallë nuk keni mjaft kohë për të luajtur me fëmijën tuaj, sepse vazhdimisht ju "ndjekin" punët? A keni menduar ndonjëherë se punët e përditshme dhe të lodhshme të shtëpisë si: gatimi, larja apo pazari do të ishin raste të mira për të luajtur dhe për të mësuar? Apo ndoshta kuzhina do të ishte një vend mësimi për fëmijën?

Nëse ndryshoni pak mënyrën sesi shikoni dhe bëni gjërat ndoshta vini re se keni më shumë kohë, sesa mendonit, në dispozicionin tuaj, që ta kaloni me fëmijën. Më poshtë do të gjeni disa ide për mënyrat me të cilat rutina e jetës sonë mund të bëhet më e këndshme dhe krijuese si për ne, ashtu dhe për fëmijët tanë. Provoni disa nga to dhe jemi të sigurtë se do të gjeni edhe shumë të tjera, sipas zakoneve që keni në shtëpinë tuaj.

Lugë e pirunj

Jepuni fëmijëve lugët dhe pirunjtë që përdorni çdo ditë dhe kërkojuni të «vënë të njëjtat (ose të gjitha lugët) bashkë». Sapo të përfundojnë grupimin e parë, mund t'u kërkoni të ndërtojnë edhe grupe të tjera duke ndarë, për shembull: lugët e kafes nga ato të supës. Përfitoni nga rasti dhe kërkoni nga fëmijët të krahasojnë masat dhe format e ndryshme dhe t'ju përshkruajnë ndryshimet. Me fëmijët më të rritur mund të filloni të bisedoni për përdorimin e «veglave» të ndryshme të kuzhinës.

Dhe sigurisht ditën që do të vendosni të bëni pastrimin e dollapeve tuaj, nxirrni të gjitha llojet e kuzhinës (që nuk janë të rrezikshme) dhe lini fëmijën tuaj të luajë dhe të krijojë kompozime të ndryshme derisa ju të mbaroni pastrimin. Të jeni të sigurtë se loja e tij do të jetë shumë krijuese. Mos harroni që para se të fillojë kjo proçedurë, të bëni një marrëveshje me të: «Gjithçka do të vihet në vendin e vet sapo të mbarojmë pastrimin *dhe nuk do t'i nxjerrim që aty në çdo kohë që duam të luajmë, por vetëm kur të pastrojmë sërish. Atëherë do të luash përsëri.»*

Filxhanët apo lugët e matjes

Lejoni fëmijët tuaj t'ju ndihmojnë në recetat e thjeshta të gatimit dhe të ëmbëlsirave. Mendoni sa shumë raste u jepni për «lexim», «shkrim», «matematikë», familjarizim me kuptimet e shkencave natyrore etj.

Mund të «lexojnë» bashkë me ju recetën (p.sh. «që të shikojmë çfarë tjetër duhet të shtojmë*… mirë, 2 gota miell»*). Mos harroni të flisni dhe të numëroni «me zë të lartë» çdo herë që pregatitni një recetë *(«tani do të shtoj dy lugë të vogla me sheqer… një dhe një tjetër…»*).

Jepuni të përdorin enë matjeje apo gota që të llogaritin sasitë e recetës.

Me një fëmijë më të madh (të moshës parashkollore dhe klasës së parë fillore) pasi «lexoni» sëbashku recetën dhe ju ndihmon në kryerjen e saj, mund t'i sygjeroni të «shkruajë» recetën (që ta çojë p.sh. në shkollë). Kjo do të thotë se ju i thoni ngadalë mjetet dhe sasitë dhe ai/ajo shënon, pikturon, shkruan (si të mundet) ato që dëgjon.

Gjatë kryerjes së recetës, provokoni fëmijët tuaj të vëzhgojnë çokollatën ose gjalpin që shkrihet kur nxehet (kur rritet temperatura shkrihen më shpejt) dhe bisedoni me ta për këtë. Kërkoni prej tyre të vërejnë ujin që nxehet në tenxhere për makaronat deri sa të vlojë (si fillojnë të krijohen flluskat e vogla duke filluar nga fundi i tenxheres dhe vijnë duke u zmadhuar e ngjiten në sipërfaqe ku dhe plasin). Vëzhgoni bashkë me ta avullin dhe pyetini: *«Çfarë do të ndodhë nëse uji vazhdon të ziejë?»*.

Kërkoni prej fëmijës suaj të masë sasinë e drithërave që kanë ngelur në kuti. Mund të përdorë një lugë që të masë sasinë e mbetur. Lëreni të llogarisë (pasi vë p.sh. 3 lugë çdo ditë në qumështin e tij/saj) në sa ditë do të mbarojë kutia. Me këtë mënyrë gazmore gatimi mund të bëhet argëtim për fëmijët e vegjël dhe të familjarizohen me mënyrat praktike të matjes së një sasie! Nëse përsërisni këtë aktivitet, me kalimin e kohës, fëmijët më të rritur do të familjarizohen me praktikën e parashikimit dhe të vlerësimit të sasisë.

Dhe një ide tjetër përderisa ndodheni në kuzhinë…

Kur doni të mbushni mbajtëset e akullit, pyetni ato, p.sh.: *«Si mund të bëjmë akuj? Nga se bëhen copat e akullit?»*. Fëmijët zakonisht thonë se duan «ujë akull». Bisedoni me ta për këtë.

Pazari i përditshëm

Shkruani listën e ushqimeve kur shkoni në supermarket? A keni menduar se edhe fëmija juaj do të mundte të shkruante listat e tij/saj? *«Por ai/ajo nuk di të shkruajë?»*, do të pyesë dikush. Kjo është e vërtetë, por mundet **të ndërtojë** listat e tij/saj edhe pse nuk di të shkruajë.

Fëmijët para se të fillojnë të shkruajnë si ne, shpesh provojnë mënyrat e tyre të shkrimit: përdorin gjoja gërma, ose shkronjat e emrit të tyre, apo ato që dinë me mënyrë të çrregullt dhe «bëjnë sikur shkruajnë». Këto praktika, kur rezultojnë nga vetë fëmijët, përbëjnë fillesën në udhën e gjatë të shkrimit.

Kështu, pra, keni mundësinë që çdo herë që shënoni listën e ushqimeve tuaja, të jepni një letër dhe një laps fëmijës suaj duke e nxitur të shkruajë-shënojë dhe ai/ajo, p.sh. *«Ke dëshirë të shkruash edhe ti, si të mundesh, çfarë kemi nevojë të blejmë në supermarket? Do të mbash listën tënde dhe do të më diktosh çfarë na nevojitet» etj. Nëse nuk ka dëshirë të shkruajë, shkruani vetëm ju, duke thënë me zë të lartë ato që shkruani çdo herë*, *«A! Duam edhe sheqer, edhe vaj…». Më vonë, në supermarket jepini listën ta mbajë* dhe të fshijë çdo gjë që vini në shportë.

Kur zgjidhni produktet, bisedoni me të pse zgjodhët A-në apo B-në (sepse është më e lirë, sepse është e cilësisë më të mirë, sepse është biologjike etj). Lexoni disa herë para tij/saj etiketën e produktit ose «gërmat e vogla», d.m.th. përbërësit dhe bisedoni me të për këtë.

Dhe kur të ktheheni në shtëpi, kush do t'i vendosë ushqimet nëpër vendet e tyre në dollap? Sigurisht fëmija juaj! Jepini shansin dhe do të shikoni se do t'ia dalë mbanë shumë mirë.

Argëtim të mbarë!

DIALOGOS Διάλογος

Enti zbatues
POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri

www.polydromo.gr
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti
Maria Birbili - Maria Papandhreu , Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Koordinatore të programit
Birbili Maria – Cokalidhu Rula
Departamenti i Shkencave të Edukimit
dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Email: mmpirmpi@nured.auth.gr
tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes
Valbona Hystuna

Përpunuan tekstin
Evi Marku

Me mbështetjen e

STAVROS NIARCHOS FOUNDATION